

MINISTRIA FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANES KAPSHTICE



**LËNDA:** Kërkesë për shpallje publike

**DREJTUAR:** DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT / TIRANE

**DREJTUAR:** DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedures Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për *vendimin per shpallje debitor, per* ;



**Subjekti:** "Shpetim Kosturi" P.F me NIPT L52116019V  
**Vendimi :** Nr 104 date 20/06/2024  
**Detyrimi:** 336.144 leke detyrime doganore.

Kerkesa paraqitet mbeshtetur ne faktin se subjekti nuk eshte njoftuar ne adresen e deklaruar dhe refuzon marrjen e njoftimit(shënim i shërbimit postar) dhe lutemi qe për vazhdimin e procedurave ligjore, me tej për rikuperimin e borxhit doganor, është domosdoshmëri data e shpalljes publike(bashkëlidhur vendimi Nr 104 date 20/06/2024).

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

**KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE**

**DRITAN ÇEKANI**



**MINISTRIA FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANES KAPSHTICE  
VENDIM**

**Nr 104 date 20.06.2024**

Ne cilesine e Kryetarit te Deges Doganore Kapshtice dhe njekohesisht te vendimarrësit, pasi shqyrtova proces verbalin Nr 1026 date 18/04/2024 (pjesë integrale e ketij vendimi) te Grupit te Punes, ngritur me Urdherin Nr. 518/1 date 06.03.2024 te Kryetarit te Deges Doganes Kapshtice "Mbi shqyrtimin, analizimin dhe Vleresimin e Rekomandimeve te lena ne Raportin Perfundimtar te Auditimit" te KLSH-se, shkresa Nr.283/93 Prot date 19.02.2024 ne lidhje me verifikimin e deklarave doganore R7214 date 11/05/2022, R 7884 date 20/05/2022, R 12083 date 28/07/2022, R 12640 date 06/08/2022, R 13697 date 30/08/2022, R 14316 DATE 09/09/2022, R 19905 date 08/12/2022, .2022 qe i perket subjektit " Shpëtim Kosturi" me NIPT L52116019V, Tirane Njesia Bashkiake nr.10, rruga Bajram Curri, ndertesa nr.3, bodrum perfaqesuar nga Agjencia: Agjencia: Spediko SI, Kapshtice

**KONSTATOVA:**

Nga proces verbali Nr 1026 date 18/04/2024 (pjesë integrale e ketij vendimi) te Grupit te Punes, ngritur me Urdherin Nr. 518/1 date 06.03.2024 te Kryetarit te Deges Doganes Kapshtice "Mbi shqyrtimin, analizimin dhe Vleresimin e Rekomandimeve te lena ne Raportin Perfundimtar te Auditimit" te KLSH-se, shkresa Nr.283/93 Prot date 19.02.2024 ne lidhje me verifikimin e deklarave doganore R7214 date 11/05/2022, R 7884 date 20/05/2022, R 12083 date 28/07/2022, R 12640 date 06/08/2022, R 13697 date 30/08/2022, R 14316 DATE 09/09/2022, R 19905 date 08/12/2022, .2022 qe i perket subjektit " Shpëtim Kosturi" me NIPT L52116019V, Tirane Njesia Bashkiake nr.10, rruga Bajram Curri, ndertesa nr.3, bodrum perfaqesuar nga Agjencia: Agjencia: Spediko SI, Kapshtice, me te cilat ka deklaruar, artikullin sipas proces verbalit te mare ne shqyrtim dhe pjesë perberese e ketij vendimi. Evidentohet se me shkrese Nr.283/93 Prot date 19.02.2024 "Raportin Perfundimtar te Auditimit" te KLSH-se, eshte konstatuar se Pranimi i transaksionit nuk ka qene i bazuar. Kjo pasi referuar indikatorëve te percaktuar ne piken 2 te Seksionit i te Udhezimit 25, date 30.1.2007 "Per procedurat e shqyrtimit te vleres doganore" i ndryshuar me piken 7 te udhezimit Nr. 3 date 23.01.2018 me qellim standartizimin dhe unifikimin e procedurave te shqyrtimit te vleres se mallit nuk eshte kner nje analize e thelluar sepse: Se pari, vlera e mallrave identike te ngjashme te pranuar me transaksion ne sistemin doganor brenda 3 muajve te fundit, ku nga verifikimi ne sistemin ORACLE rezulton se çmimi per te njejtin artikull nga e njejta origjine, nga i njejtin eksportues per te njejtin importues paraqitet i ndryshem.

Se dyti, vlera e mallrave te derguara zyrtarisht nga Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave si te dhena te disponueshme etj, ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruar dhe transaktuar te artikujve ne sistemin ORACLE, krahesuar me çmimet e publikuara ne faqen zyrtare te DPD dhe te miratuara nga komisioni Add-Hoc prane Ministrise se Financave jane shume te uleta.

Se treti, Vlera e produktit nuk mund te jete me e ulet se vlera e lendes se pare me te cilen eshte prodhuar ku nga verifikimi rezulton se çmimet deklaruar dhe transaktuar te artikujve ne sistemin ORACLE ne disa raste jane nen çmimin e lendes se pare.

Se katerti, vendi i origjines me risk, Azise, Lindjes se larget, Vendet Arabe, Zonat e lira, ku nga verifikimi rezulton se jane trajtuar me transaksion mallrat e importuar nga keto vende te cilat percaktohen me risk te larte me te cilat administrata doganore nuk ka mareveshje bashkepunimi.

Se pesti, fatura nuk eshte leshuar nga vendi i origjines ndryshon nga vendi ku levrohet malli, rezulton se nga verifikimi transaksioni eshte kryer nga kompani me seli te ndryshme nga vendi i origjines dhe derguesi i mallit.



Se gjashti, kontrata me firmen shitese, permbajtja e faturave nga i njeiti furnizues paraqet luhatje jo te zakonshme ne vlerë, konstatohet se nga verifikimi per import nuk rezulton kontrate me firmen shitesë bashkengjitur praktikave doganore.

Se shtati, ne asnje rast nuk eshte bere asnje investigim lidhur me verifikimin e faturave te deklaruar apo verifikim posterior nga grup i perbashket lidhur me çmimin e produkteve ne treg. Subjekt dhe perfaqesuesi i subjektit agjensine doganore "Spediko S&I Kapshtice kane vleresuar paraqitjen e pretendimeve dhe kundershimitin e tyre, ku me shkrese Nr.700 Prot date 18.03.2024 sqarojne se: "Ne kemi aplikuar vleresimin me fature dhe doganieret e vleresimit ne Tirane kane aplikuar, vleresimin me transaksion. Astari-metrazh stok ose ndryshe "demode" meret nga magazinat ne Greqi qe i ka kaluar afati i qendrimit ne rafle dhe perdorej jo per fasoneri, rrobaqepsi por per veshje ne mobilerite e tjera, shif faturen me vleren qe ka bashkengjitur. Marja e mostres sipas ligjit dhe pergjigje e laboratorit percaktoi cfare cilesie malli eshte dhe percaktimi i kodit".

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit Nr. 102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", VKM Nr.651 date 10.11.2017, "Per Miratimin e Dispozitave Zbatuesc te Ligjit Nr. 102/2014 date 31.07.2014", Udhezimit Nr.3 date 23.01.2018 "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore", Grupi i Punes verifikoi deklaratat doganore ku rezulton se subjekti ka deklaruar per qarkullim te lire Artikullin - "metrazh(astar)", sipas pershkrimtit te hollesishem ne proces verbalin pjese perberesee ketij vendimi.

Evidentohet se ne momentin e depozitimit te deklaratave doganore sistemi ne menyre automatike ka bere perzgjedhjen e tyre ne kanal te verdhe, çka do te thote se per kete deklarate ushtrohet vetem kontroll dokumentar dhe se gjate perpunimit te deklaratave doganore nga sektori SVQ ne DPD nuk eshte pranuar vlera e transaksionit, por eshte nderhyre me vleren 0.33 euro/ml, referuar dosjes se te dhenave te disponueshme-astar me peshe me shume se 130 g/ml dhe detyrimi i paguar 226.109 leke. Evidentohet ne proces verbalin e marre ne shqyrtim, qendrimi se eshte normale qe cdo e dhene ne deklarate doganore te bazohet ne dokumenta, por nga verifikimi i kryer nga ana jone rezulton se disa te dhena qe jane pasyruar ne deklaratat doganore nuk mbeshteten ne dokumenta, konkretisht origjina e mallrave ne kutia 34 e DA V-i-Kodi i vendit te origjines eshte deklaruar \*GR\* pa dokument prove origjine, ne kutia 31 e DAV-it.

Pershkrimi i mallit eshte deklaruar sasia ml) pa nje dokument shoqerues, po ashtu ne kutia 41 e DAV-it-"Njesia plotesuese" eshte deklaruar m<sup>2</sup>, deklaruar pa pasur dokument shoqerues si packing list ose ndonje dokument tjeter qe percakton lidhjen midis peshes, metrit liner dhe metrit katror, kur dihet qe nje meter linear nuk mund te konvertohet direkt ne meter katror pa nje dimension tjeter (ml dhe llogaritja e m<sup>2</sup> eshte vendosur pa u bazuar ne dokumnta). Evidentohet gjithashtu se nga analiza e indikatorëve te shqyrtimit te vleres doganore mbeshtetur ne Udhezimin Nr.03 date 23.01.2018, te Ministrit te Financave dhe Ekonomise "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore" per artikullin -"Metrazh (Astar), klasifikuar ne kodin tarifar \*54076990\*, evidentohet se ekziston nje ndryshim i dukshem midis cmimit te deklaruar dhe cmimeve ne te dhenat e disponueshme konkretisht Urdher Nr. 779 Prot, date 16.01.2014 "Mbi rishikimin e disa indikatorëve kontrolli shtese ne vleresimin doganor te mallrave me origjine nga vende jashte BE/NEU.

-Dokumentacioni shoqerues nuk eshte i plote, pasi mungojne: Kontrate me firmen shitesë, fatura e pagesave per transport dhe siguracioni malli; dokumenta te kushteve te levimit te mallit dhe dokument transporti, dokumenta bankare qe vertetojne transferimin faktik te shumave monetare ne lidhje me transaksionin e kryer; nuk ka dokumenta per verifikim dhe konfirmim te faturave nga DOH apo aplikim prane deges per plotesim dosje per trajtim me transaksion. Per keta artikull ne data base kombetar te vleresimit ka historik nderhyrjesh-Vleresim bazuar ne metoden e te dhenave te disponueshme.

Gjithashtu kokludohet se vlera doganore e mallrave nuk mund te percaktohet ne baze te nenit 66 te Ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" duke

u bazuar vetem ne cmimin e blerjes pa marre dokumentat shtese ne mbeshtetje te transaksionit si kontrate me firmen ekspotuese, fatura e pagesave per transport dhe siguracion malli, dokumenta justifikuese te kushteve te levrimet te mallit, dokument transporti, etj.

Referuar bazes. ligjore ligjit, Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", VKM Nr.651 date 10.11.2017 "Per Miratimin e Dispozitave Zbatuese te Ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014", Udhezimit Nr.3, date.23.01.2018 "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore", ne rastet kur vlera e transaksionit nuk justifikohet plotesisht per vleresimin e mallrave ne fjale "Astar" do te perdoren sipas radhes metodat e vleresimit duke u ndalur te metoda e pare per te cilen ka te dhena te mjaftueshme.

Evidentohet se jane shqyrtuar dhe gjetur te pa zbatueshme te gjitha metodat e tjera te vleresimit te parashikuara ne nenet 66, 70/1/2 te, ligjit 102/2.014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" vlera doganore per artikullin "ASTAR", klasifikuar ne kodin tarifor \*5407\* percaktohet bazuar Met.vlera e te dhenave te disponueshme i duke dhene perparesi urdherit te Drejtarit te Pergjithshem te Doganave Nr.779 Prot date 16.01.2014 "Mbi rishikimin e disa indikatoreve kontrolli shtese ne vleresimin doganor te mallrave me origjine, nga vende jashte BE/NEU" cmimi - jo me pak se cmimi jo me pak se 450 lek/kg/cif. Grupi i Auditimit te KLSH- se nga shqyrtimi i deklaratave doganore te lartpermendura dhe dokumentacionit bashkelidhur tyre, ka konkluduar ne te njeten metode vleresimi qe ka aplikuar personeli perpunes i deklaratave doganore-metoden e vleres se te dhenave te disponueshme, por ndryshimi qendron ne cmimi i aplikuar ku SVQ ka aplikuar cmimin referues 0.33 €/ml qe gjendet ne DRV, ndersa KLSH- ja rekomandon aplikimin e cmimit jo me pak se 450 lek/kg/cif, referuar urdherit Nr.779 Prot date 16.01.2014, te Drejtorit te Pergjithshem te Doganave.

Grupi i Punes se Deges Doganes Kapshtice nga shqyrtimi i pretendimeve te subjektit evidentuar ne kerkesen Nr. 700 Prot dat 18.03.2024 vlereson se:

a) Ne lidhje me pretendimin se: ne kemi aplikuar, vleresimin me fature dhe doganieret e vleresimit ne Tirane kane aplikuar, vleresimin me transaksion, Grupi i Punes evidenton se subjekti ka depozituar deklaraten doganore ne sistem referuar cmimit te faturave, ndersa vleresimi dhe percaktimi i vleres doganore te mallrave eshte kryer nga personeli doganor perpunes, sektori SVQ ne DPD i cili mbasi ka shqyrtuar dokumentat shoqeruese ka vendosur per mospranimin e vleres se transaksionit.

b) Ne lidhje me pretendimin se Astari eshte metrazh stok ose ndryshe "demode" meret nga magazinat ne Greqi, qe i ka kaluar afati i qendrimit ne rafte dhe perdoret jo per fasoneri, robaqepsi por per veshje ne mobilerite shif faturen me vleren qe ka bashkengjitur, per te cilen Grupi i Punes ka vleresuar se pershkrimi i mallit dhe ose dokumentacioni i mallit nuk eshte mjaftueshem i sakte per te gjykuar nese malli eshte stok apo jo.

Ne konteksin e tregetise "STOK" zakonisht i referohet mallit qe eshte grubulluar ne magazine dhe shpeshhere shitet ngadale. Ne proceduren e importit dhe zhdoganimit te mallrave per te vertetuar qe malli eshte "stok" duhen le paraqiten dokumenta te caktuara qe tregojne origjinen e mallit, kohen e blerjes dhe detajet e magazinimit, regjistrat e magazinimit dhe cdo dokument tjeter qe verteton se malli ka qene Siok per nje periudhe te caktuar kohe para importit. Ndersa "DEMODE" ne shqip do te thote dicka qe ka dale nga moda qe nuk eshte me aktuale ose e 'perdorur' gjeresisht. Kjo mund te aplikohet per veshje, stile, teknologji ose cdo trend tjeter qe konsiderohet i "vjeteruar". Fjala dernode zakonisht nuk perdoret ne konteksin e metrazhit, pelhurave ose astarit. Ne rastin e metrazheve (astarit) me e pershtatshrne do te ishte flitet per cilesine dhe llojin.

Percaktimi i vleres se mallrave eshte nje proces specifik i cili bazohet ne ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", VKM Nr.651 date 10.11.2017 "Per Miratimin e Dispozitave Zbatuese te Ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014", Udhezimit Nr.3, date 23.01.2018 " Per vleresimin e mallrave per qellime doganore" shqyrtimi bazohet ne dokumenta

shoqruese dhe dokumenta shtese te kerkuara ne qofte se eshte e nevojshme dhe jo ne perdorimin specifik sikur pretendoni konkretisht ne fasoneri, rrobaqepsi apo veshjen e mobilerive. Ne lidhje me pretendimin se maria e mostres sipas ligjit dhe pergjigia e laboratorit peraktori cfare cilesie malli dhe kod tarifar eshte Grupi i Punes vlereson se certifikata e laboratorit leshohet ne varesi te kerkeses qe eshte bere pra cfare kerkon autoriteti qe ka kryer mostrimin. Zakonisht ne mostrat e marra nga Dogana Kapshtice eshte kerkuar klasifikimi i sakte tarifar si ne rastin qe ju pretendoni mbasi nuk mund te percaktoje laboratorin nese nje mall eshte stok apo jo dhe perfundimisht kundershimitet e subjektit dhe perfaqesuesit te subjektit dhe deklaruesit nga Grupi i Punes jane vleresuar te pambeshtetura.

Referuar argumentimit te bere ne process verbalin e mare ne shqyrtim i cili gjendet e mbeshtetur ne dispozitat ligjore te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", VKM.651 date 10.1 1.2017,"Per Miratimin e Dispozitave Zbatuese te Ligjit Nr. 102/2014 date 3/07.20/4", Udhezimit Nr.3 date 23.012018 "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore", ne rastet kur vlera e transaksionit nuk justifikohet plotesisht per vleresimin e mallrave ne fiale dhe duhet te perdoren sipas radhes metodat e vleresimit duke u ndalur te metoda e pare per te cilen ka te dhena te mjaftueshme. Mbasi jane shqyrtuar dhe gjetur te pa zbatueshme te gjitha metodat e tjera te vleresimit te parashikuara ne nenet 66, 70/1/2 te ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" vlera doganore per artikullin duhet te percaktohet duke perdorur Met.VI-Vlera e te dhenave te disponueshme- çmimi 450 leke/kg/cif.

Ndaj duke u mbeshtetur ne nenet 60-65 te Ligjit 102/2014 date 31/07/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise, nenet, 6 pika 20, neni 65-70, 49, VKM.651 date 10.1 1.2017,"Per Miratimin e Dispozitave Zbatuese te Ligjit Nr. 102/2014 date 31. 07.2014", Udhezimit Nr.3 date 23.012018 "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore", ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative".

#### VENDOSA

- 1)Subjekti " Shpëtim Kosturi" me NIPT L52116019V, Tirane Njesia Bashkiake nr.10, rruga Bajram Curri, ndertesa nr.3, bodrum perfaqesuar nga Agjencia: Agjencia: Spediko SI, Kapshtice te paguaje detyrimin doganor prej 336.144(treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e kater) leke
- 2) Kontrolli Aposterior i deges te kryeje veprimin e amendimit te deklarave doganore me qellim permbushjen e disponimit si me sipër.
- 3) Kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ankim para Drejtorit te Pergjithshem te Doganave, ne afatin 30 ditor nga marja dijani per vendimin, duke plotesuar kushtin e pageses se detyrimit te vendosur me kete vendim, ne mbeshtetje te nenit 280 e vijues te ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise".

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE  
DRITAN ÇEKANI

